



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.50, datë 28.09.2007

**“MBI DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË TIRANË PËR VITIN
2007”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19, pika 9, neni 32, gërma “dh”, ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993, “Për Buxhetin lokal”, neni 18 dhe 21, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09.09.1998, Ligjit Nr.9645 date 27.11.2006 “Per Buxhetin e shtetit te vitit 2007”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.23 dt.30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2006 dhe detajimin e Buxhetit të vitit 2007”, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave me Nr.4744/1 date 4.07.2007, Nr.959/43 date 26.07.2007, si dhe Nr.2240/3 datë 5.07.2007 me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë disa shtesa në fondin e investimeve në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës nga granti konkurses për vitin 2007, sipas listës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Të miratojë ndryshimin e burimit të financimit, për objektin “Rikonstruksion i urës te Dëshmorët e 4 shkurtit”, nga të ardhurat e Bashkisë, miratuar me Buxhetin e Bashkisë për vitin 2007, në fondin e investimeve të miratuar nga granti konkurses.
3. Të miratojë transferimin e fondit të investimeve nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës të objektit «Rikonstruksion i urës te Dëshmorët e 4 shkurtit”, në shumën prej 39.000.000 lekësh, duke shtuar në po këtë shumë fondin e investimeve për objektin “Sistemimi i Shtratit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralel saj (Faza e parë).Objekti të prokurohet në vlerën e plotë prej 152.772.000 lekësh dhe diferenca e fondit të parashikohet në Buxhetin e vitit 2008.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R

